



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:254866
Datë: 31.01.2025
Numri i dokumentit: 06787483

Rev.nr.463/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Rrustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses J. H. P., nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson Visar Vehapi, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës I. T. LLC, me adresë Rr.”Z. Sh.” nr., P., të cilën me autorizim e përfaqëson Isamedin Dedinca avokat në Prishtinë, me objekt të padisë anulim vendimi, kthim në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5937/21, të datës 05.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht i themeltë revizioni i të paditurës I. T. LLC, me seli në P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5937/21, i datës 05.07.2024, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.529/2016, i datës 01.02.2021, në pikën II dhe IV të dispozitivit, që ka të bëjë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditëses për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale nga data 28.12.2020, e deri në kthimin në vendin e punës, ku tani gjykohet si në vijim: Refuzohen të pabazuara pjesa e kërkesëpadisë së paditëses J. H. P., nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura I. T. LLC, me seli në P., që paditësen ta kthejë në vendin e punës që i përshtatet aftësive dhe përgatitjes së saj profesionale, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe pjesa e kërkesëpadisë së paditëses që të detyrohet e paditura që paditëses ti paguaj shumën prej 449.00€ në muaj, në emër të pagës mujore nga data 28.12.2020, e deri në kthimin në vendin e punës.

II. Refuzohet pjesërisht i pathemeltë revizioni i të paditurës I. T. LLC, me seli në P., i parashtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5937/21, të datës 05.07.2024, me të cilin janë vërtetuar pikat I, III dhe IV e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.529/2016, të datës 01.02.2021, që kanë të bëjnë me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditëses për anulim vendimi, kompensimin e të ardhurave personale deri me datë 28.12.2020, si dhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.529/2016, të datës 01.02.2021, është vendosur: “I. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses J. H. P. nga P., Anulohet vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së Punës Nr.4839, i datës 10.02.2016, si i kundërligjshëm.

II. Detyrohet e paditura I. T. LLC, me seli në P., që paditësen ta kthej në vendin e punës që i përshtatet aftësive dhe përgatitjes së saj profesionale me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. III. Obligohet e paditura I. T. LLC që paditëses J. H. P. nga P., ti kompensoj të ardhurat personale dhe të drejtave tjera ligjore për periudhën nga data 01.03.2016, deri me datë 28.12.2020, shumat si në vijim: në emër të pagave neto për periudhën e lartcekur shumën prej 23.527,00 euro (njëzet e tremijë e pesëqind e njëzet shtatë euro); në emër të kamatës ligjore shumën prej 4,469.00 euro, (katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë euro), gjithsej shumën prej 27,996.60 €; në emër të tatimit që duhet ti paguhet ATK-së shumën prej 1.213,00 euro (një mijë e dyqind e trembëdhjetë euro); në emër të kontributit pensional shumën prej 2.604,40 (dy mijë e gjashtëqind e katër euro e dyzet cent), në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor. IV. Detyrohet e paditura që paditëses ti paguaj shumën prej 449.00€ në muaj, në emër të pagës mujore nga data 28.12.2020 e deri në kthimin në vendin e punës, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 741,00 € në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit ligjor”.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së paditurës, me aktgjykimin Ac.nr.5937/21, të datës 05.07.2024, e ka refuzuar të pabazuar ankesën e të paditurës I. T. LLC, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.529/2016, të datës 01.02.2021, e ka vërtetuar në tërësi.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj në tërësi si të bazuar revizionin e të paditurës, të ndryshohen aktgjykimet e instancave më të ulëta dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpapia e paditëses.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja Jehona Hajdini Prekadinaj, përmes të autorizuarit të saj, me datë 14.03.2016, ka paraqitur padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet në tërësi kërkesëpapia e përshkruar si më lartë.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.529/16, të datës 01.02.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ka theksuar se në bazë të provave të administruara gjykata ka gjetur së kërkesëpapia e paditëses është e bazuar, ngase nga administrimi i provave në këtë çështje juridike rezulton se ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditëses është bërë pa ndonjë periudhë paralajmërimi nga e paditura. Në bazë të dispozitës së nenit 70 par. 1.6 është përcaktuar se:” *punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim*”, pra ndërprerja e punës pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit bëhet vetëm në këto dy raste, e që në rastin konkret nuk

kemi të bëjmë me asnjërin rast, kjo ngase nuk kemi një përsëritje të një keq sjellje nga ana e paditëses, sikurse nuk kemi as një performancë të pakënaqshme nga ana e paditëses pas ndonjë paralajmërimi nga e paditura. Pretendimet e palës së paditur se ndërprerja e marrëdhënies së punës është bërë në përputhje me Politikën për Procedurën disiplinore dhe ankimore ADM.HR.12 të së paditurës, duke iu referuar nenit 4.2 pika 4.2.3, për Gjykatën nuk janë të qëndrueshme, kjo ngase sipas nenit 95 të Ligjit të Punës, pjesa që ka të bëjë me harmonizimin e akteve të brendshme për punëdhënësit është përcaktuar se: *“Punëdhënësit janë të obliguar që aktet e brendshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës, t’i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të tij; 2. Deri në nxjerrjen e akteve të brendshme nga paragrafi 1. i këtij neni, drejtpërsëdrejti aplikohen dispozitat e këtij ligji”*, që nënkupton se Politika për Procedurën disiplinore dhe ankimore ADM.HR.12, përkatësisht neni 4.2 pika 4.2.3 të cilit i referohet e paditura, nuk është në harmoni me dispozitat e ligjit të punës, kjo ngase ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit pa periudhën e paralajmërimit, bëhet vetëm në dy raste siç u cekë më lartë dhe se nuk është në diskrecion të punëdhënësit të përcaktoj kushte të veçanta, përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa periudhën e paralajmërimit. Nga gjendja faktike e vërtetuar faktike si më lartë si dhe dispozitat e cekura gjykata anuloi si të kundërligjshëm Vendimin nr.4839 të dt.10.02.2016 të lëshuar nga e paditura për ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke marr për bazë faktin se paditësja ka mbi 3 vite përvojë pune tek e paditura e njëjta ka statusin e punëtore në kohë të pacaktuar. Me nenin 10 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, par. 5 është paraparë së *“Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3)vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar”*, andaj në këtë kontekst gjykata vlerëson së marrëveshja e përgjithshme kolektive është e detyrueshme edhe për të paditurën, ngase kjo marrëveshja në atë kohë ishte në zbatim nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2017

Gjykata e Apelit në procedurën ankimore ka vlerësuar se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, si dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për çka edhe e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e palës paditëse, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Më tutje ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore sipas të cilave gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar si duhet gjendjen faktike, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe ligjshëm ka vendosur për aprovimin e kërkesëpadisë së paditëses, duke marr parasysh shkresat e lëndës. Në bazë të vendimit nr.4839, të nxjerr nga e paditura me datën 10.02.2016, këtu paditëses i është ndërprerë kontrata e punës. Në këtë rast, rezulton se paditësja pas pranimit të vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës ka paraqitur ankesë e cila është refuzuar me vendimin nr.4996 të datës 22.02.2016. Në bazë të dispozitës së nenit 70, par. 1.6 të Ligjit të Punës është përcaktuar se: *“Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keq sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim”*. Në rastin konkret ndërprerja e punës pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit bëhet vetëm sipas dispozitës së lartcekur e meqë nuk kemi të bëjmë me këto shkelje pasi paditësja nuk ka bërë përsëritje të keq sjelljes, si dhe nuk kemi as një performancë të pakënaqshme pasi që nga vlerësimi i datës 23.04.2014, vërtetohet se paditësja kishte vlerësime të kënaqshme për punën e kryer nga e paditura, në këtë raste e paditura ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të sipër theksuara, si dhe të Politikës për procedurën disiplinore dhe ankimore

ADM.HR.12, të nxjerrë nga vet e paditua, gjegjësisht nenit 4, pika v) dhe neneve 6, 7, 8, 9 dhe 10, pasi që paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës pa shqyrtimin e brendshëm siç është paraparë me këto politika dhe pa themeluar komision të veçantë disiplinor, por se vendimi është marrë drejtë për drejtë nga drejtori ekzekutiv, me çka ka rezultuar si i kundërligjshëm. Nuk qëndron pretendimi ankimor për zbatim të gabuar të së drejtës materiale pasi që në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 10, paragrafi 5 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e cila ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015, dhe ka qenë në zbatim në kohën kur paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, ku sipas kësaj dispozite përcaktohet se: "Kontrata e Punës, për një periudhë të caktuar, që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme, për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3) vite, do të konsiderohet si kontratë e lidhur në kohë të pacaktuar", andaj në këtë rast Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive është e detyrueshme edhe për të paditurën. Në bazë të shkresave të lëndës vërtetohet se paditësja ka mbi 3 vite përvojë pune tek e paditura dhe se e njëjta sipas dispozitës së lartcekur ka statusin e punëtores në kohë të pacaktuar, ndërsa me aneks kontratë i është vazhduar marrëdhënia e punës nga data 31.01.2016 e deri me 31.01.2021.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare, përveç pjesës së ndryshuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për të cilën kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se me rastin e vendosjes është zbatuar gabimisht e drejta materiale nga gjykatat e instancës më të ulët.

Në lidhje me pretendimet e palës së paditur të cekura në revizion se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marr me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht nenit 182.2 pika n) të LPK-së, të njëjtat kanë rezultuar të pabazuara. Kjo për faktin se referuar përmbajtjes së aktgjykimeve të atakuara me revizion, rezulton se të njëjtat janë mjaft të qarta, të mbështetura në vërtetimin e fakteve vendimtare, si dhe janë hartuar në përputhje me dispozitën e nenit 160 të LPK-së. Përveç kësaj, sipas Gjykatës Supreme aktgjykimet e goditura me revizion, nuk janë përfshirë në shkelje esenciale nga neni 215 të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës e ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, për çka edhe është vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në lidhje me këtë, është i drejtë dhe i ligjshëm qëndrimi juridik i gjykatave të instancave më të ulëta se e paditura ka bërë shkelje ligjore me rastin e marrjes së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditëses. Kjo për faktin se vendimi i të paditurës nr.4839, datë 10.02.2016, me të cilin paditëses i është ndërprerë marrëdhënia e punës, me të drejtë është vlerësuar i paligjshëm, pasi që i njëjti është marr në mos respektim dhe zbatim të plotë të dispozitave të Ligjit të Punës dhe Politikën për Procedurën disiplinore dhe ankimore ADM.HR.12, të paditurës.

Në lidhje me këtë, nuk qëndrojnë pretendimet e revizionit se e paditura me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditëses, ka zbatuar në mënyrën e duhur dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht nenin 70 paragraf 1.4.1, si dhe nenin 4 paragraf 2 nën paragraf 4.2.3 të aktit të brendshëm të cekur më lartë. Në këtë drejtim, është vlerësim i Gjykatës Supreme se referuar shkresave të lëndës dhe përmbajtjes së aktgjykimeve të instancave më të ulëta, rezulton si fakt i provuar se në

rastin e paditëses, përkundër detyrimit ligjor që për konstatimin e shkeljeve të detyrave të punës nga paditësja për të filluar, mbajtur dhe përfunduar procedura disiplinore, këtë e paditura nuk e ka bërë, për çka me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 70 paragraf 1.6, pika 1.6.1 dhe 1.6.2, lidhur me dispozitën e nenit 71 paragraf 2 të Ligjit të Punës. Përveç kësaj, është i drejtë qëndrim juridik i instancave më të ulëta se e paditura në rastin e paditëses ka vepruar edhe në kundërshtim me aktin e brendshëm të saj, përkatësisht Politikën për Procedurën disiplinore dhe ankimore ADM.HR.12. Si rrjedhojë, referuar këtij akti të brendshëm, më saktësisht pikës 3.2, 4.1.1 shkronja v), pikës 4.2, 4.2.1, 4.2.2, 4.2.3, 4.2.4 dhe 4.2.5, pastaj nenit 5 dhe 6, është përcaktuar qartë nga vet e paditura se si duhet të veprohet në rastet kur ka pretendime për shkelje të rënda të detyrave të punës, përfshirë këtu iniciimin, mbajtjen dhe përfundimin e procedurës disiplinore, të cilat në rastin e paditëses me të drejtë është konstatuar nga gjykatat e instancës më të ulët se e paditura nuk i ka zbatuar fare, si rezultat i të cilës edhe një vendim i tillë me të drejtë është anuluar si i paligjshëm.

Në anën tjetër, është i pabazuar pretendimi në revizionin e të paditurës, se me mënyrën e vendosjes së gjykatave të instancave më të ulëta, të njëjtat kanë tendencën që të *“paraqesin një lloj sigurie, ambient ideal, precedent të rrezikshëm për kryerjen e vjedhjeve dhe kryerjen e mashtrimeve në mënyrë të vazhdueshme nga punëtorët e të paditurës...”*. Kjo për faktin se në njërin anë një pretendim i tillë nuk mbështetet në asnjë provë të vetme materiale, ndërsa në anën tjetër është komplet e kundërta e asaj që ka pretenduar e paditura në revizion, pasi që në konteste të tilla, gjykata ka tagër që të vlerësojnë ligjshmërinë e procedurës së zhvilluar nga punëdhënësit dhe ligjshmërinë e vendimarrjes në rastet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës punëmarrësit. Nga ky vlerësim i ligjshmërisë së procedurës dhe vendimarrjes së të paditurës në rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditëses, ka rezultuar se është pikërisht e paditura që ka vepruar në mënyrë arbitrare dhe pa e zbatuar procedurën e paraparë me ligj dhe me vet aktin e saj të brendshëm, duke cenuar rëndë të drejtat e paditëses që rrjedhin nga marrëdhënia e punës. Shto këtu edhe faktin, se përkundër përdorimit të shpeshtë në revizion të fjalës *“vjedhje dhe mashtrim”*, nuk rezulton që e paditura të ketë iniciuar ndonjë procedurë penale ndaj këtu paditëses, pasi që edhe vjedhja dhe mashtrimi janë vepra penale të sanksionohen me Kodin Penal. Si rezultat i kësaj, nëse e paditura do të zbatonte me përpikmëri dispozitat e Ligjit të Punës dhe të Aktit të Brendshëm, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës paditëses, duke e vërtetuar me saktësi shkeljen e pretenduar të detyrave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në bazë të ankesës së ankuesit S. H., atëherë edhe vendimarrja e gjykatave të instancave më të ulëta, do të merrte për bazë këto rrethana.

Si rrjedhojë, edhe me të drejtë është vlerësuar nga gjykatat e instancës më të ulët se vendimi i të paditurës për ndërprerje të marrëdhënies së punës paditëses është i paligjshëm, pasi që i njëjti është marr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës dhe Aktit të Brendshëm të paditurës, duke e anuluar të njëjtin. Si rezultat i kësaj, me të drejtë gjykata e shkallës së dytë ka vendosur të refuzojë ankesën e palës së paditur, duke vërtetuar pikën I dhe III të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Në lidhje me këtë, është i drejtë qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët, lidhur me detyrimin e të paditurës që si rezultat i ndërprerjes së paligjshme të marrëdhënies së punës, paditëses në bazë të nenit 55, lidhur me nenin 80 paragrafi 1, pika 1.1 të Ligjit të Punës, ti kompensoj të ardhurat personale për periudhën nga data 01.03.2016, deri me datë 28.12.2020 (deri në skadim të kohëzgjatjes së aneks kontratës së punës), në shumë të përgjithshme prej 27,996.60 euro, në të cilën është përfshirë edhe kamata e arritur, tatimi në pagë dhe trusti pensional. Kjo me të drejtë është bërë bazuar në ekspertizën e ekspertit financiar R. F., të datës 28.12.2020, e cila vlerësohet profesionale dhe e besueshme edhe nga kjo gjykatë.

Në anën tjetër, Gjykatës Supreme i rezultuan të bazuara pretendimet në revizionin e të paditurës, që kanë të bëjnë me mënyrën e vendosjes së gjykatave të instancave më të ulëta, për aprovimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditëses për kthim në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurave personale nga data 28.12.2020 e deri në kthimin në vendin e punës. Kjo për faktin se në këtë rast, gjykatat e instancës më të ulët gabimisht e kanë zbatuar të drejtën materiale, për çka edhe është pranuar pjesërisht revizionit i të paditurës dhe është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Në lidhje me këtë, referuar shkresave të lëndës rezulton se paditësja së fundmi marrëdhënien e punës me të paditurën e ka vazhduar përmes aneks kontratës së datë 31.01.2016, ku në nenin 2, palët janë pajtuar që kontratën e punës të lidhur me datë 14.01.2013, ta vazhdojnë nga data 30.01.2016 deri me datë 31.01.2016. Nga kjo rezulton se kontrata e punës së paditëses është lidhur në kohë të caktuar, në pajtim me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.2 të Ligjit të Punës. Ndërsa gabimisht gjykatat e instancës më të ulët të njëjtën e kanë konsideruar si kontratë në kohë të pacaktuar, në pajtim me nenin 10 paragraf 5 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, e cila ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015. Në rastin konkret, zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës, përkatësisht 10 paragrafi 2, pika 2.2, e jo dispozitat e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pasi që dispozita e nenit 10 paragraf 5 e kësaj të fundit është në kundërshtim me nenin 4 paragraf 1 të Ligjit të Punës, për çka edhe në këtë rast nuk ka efekt juridik. Meqenëse, paditësja me të paditurën kanë lidhur kontratë pune në kohë të caktuar, duke i përcaktuar të drejtat dhe detyrimet reciproke, përfshirë këtu edhe kohëzgjatjen e kontratës së punës, atëherë edhe pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për kthim në vendin e punës është e pabazuar, për çka edhe është refuzuar nga kjo gjykatë. Si rezultat i kësaj, edhe pjesa e kërkesëpadisë së paditëses për detyrimin e të paditurës për pagimin e pagës mujore në shumë prej 449 euro nga data 28.12.2020, e deri në kthimin e saj në vendin e punës është dashur të refuzohet si e pabazuar, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për sa i përket vendimit për shpenzimet e procedurës, edhe i njëjti rezulton të jetë marr në përputhje me nenin 452.1 të LPK-së, lidhur me tarifën e OAK-së.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.463/2024, datë 30.01.2025

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Lumni Sallauka